



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejta, Interesa të Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 30.09.2015, në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, kryetare, Agim Çeku, nënkryetarë i parë, Mufera Shinik, nënkryetarja e dytë, Sasha Milosavljević, Agim Kikaj, Rustem Berisha, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Veton Berisha dhe Slavko Simiq, anëtarë.

Mungon: Milka Vuletić, anëtare

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësues e OSBE-së Ardiana Gashi, përfaqësues nga KDI-Nora Kelmendi, Mërgime Kajtazi, përfaqësues e EUSR/EU Blerta Bejtullahu, përfaqësues i KAAD Artan murati, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tishma, Zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar dhe miratuar ky:

R e n d d i t e:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Procedurat e pranimit të kandidatëve të komunitetit jo shumicë për regjistrim në nivel Univerzitar, për vitin 2015/16**
I ftuar: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami.
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Kryetarja** – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Procedurat e pranimit të kandidatëve të komunitetit jo shumicë për regjistrim në nivel Univerzitar për vitin 2015/16

I ftuar: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Arsim Bajrami.

Kryetarja, hap për shqyrtim pikën e tret të rendit të ditës:

Kryetarja, theksoi se Komisioni për ditën e sotme ka ftuar në takim ministrin z. Arsim Bajrami, mospjesëmarrja e tij paraqet neglizhencë nga se ka përgjegjësi ti shtyj përpara çështjet e arimit, në të gjitha nivelet.

Sot jemi informuar se anëtarët e GP 6+ kan takuar ministrin Bajrami dhe kërkoi që të njejtit të deklarohen para komisionit lidhur me bisedën e zhvilluar për situatën e krijuar për regjistrim të studentëve të komunitetit jo shumicë, në vendet e rezervuara të Universitetit të Prishtinës, për vitin akademik 2015/16.

Myfera Sinik – Nuk arsyetohet mosprezenca e ministrit në mbledhje të komisionit pasi i njëjti bart përgjegjësi për dhënien e informatave se deri ku ka arritur kërkesat tona.

E njoftoi komisionin se pas përfundimit të seancës plenare, në zyrat e GP 6+ është ftuar ministri z. Arsim Bajrami, me kërkesë të promovoj për ecurit e procedurave të cilat nuk janë plotësuar në konkursin e rregullt për regjistrimin e kandidatëve të komunitetit jo shumicë, në nivel të parë, të vitit akademik 2015/2016. Ne, kemi dal me kërkesë që ti bëhet trusni z. Ramadan Zejnullahu, me qëllim të shpall konkurs për regjistrim të studentëve të komunitetit jo shumicë, për afat të tretë. Në kuadër të bisedave, ministri na ka premtuar se do ti drejtohet me shkresë Rektoratit të UP-së, që në afat sa më të shkurtur kohor të shpall konkursin plotësues, për kandidatët e komunitetit jo shumicë.

Qerim Bajrami - Sa i përket bisedimeve që kemi zhvilluar me ministrin z. Bajrami, paraprakisht ju informoj kolegja znj. Myfera. Konsideron se nuk është mirë të fajësohet askush pasi e vetmja alternativ ka qen kërkesa që të ndërmerren veprimet e nevojshme për shpalljen e konkursit plotësues. Për problemet e tilla, edhe krahas apeleve, ende nuk ka ndonjë reagim nga MASHT-i apo Rektorati i UP-së, edhe për kundër faktis se ministri ka premtuar që do të ketë afat shtes, për regjistrimin e studentëve të komunitetit jo shumicë.

Për situatën e krijuar për mos shpalljen e konkursit nga ana e Rektoratit të UP-së për afat të dytë, konsideron se është shkelje procedurale, nga se konkursi nuk është dasht të shpallet i njëanshë vetëm për kategoritë me benificione nga regjioni por të planifikohet edhe për pjesëtarët e komunitetit jo shumicë. Theksoi se ende nuk janë shtypur testet në gjuhën amtare të komuniteteve, ose së paku në gjuhët tjera zyrtare. Këto janë arsyt themelor që ka ndikuar në mos plotësimin e testeve për provimi pranues në univerzitet.

Si përfaqësues i komunitetit boshnjak, kërkojë nga MASHT-i dhe Rektorati i UP-së që të mundësohet shpallja e konkursit në afat të tretë për regjistrimin e pjesëtarëve të komuniteteit boshnjakë, turq, rom, ashkali, egjiptian dhe kroatë. Në të kundërtën, ne konsiderojmë se bëhet fjalë për diskriminim ndaj të drejtave tona, të cilat janë të garantuara me ligjet e Republikës së Kosovës.

Veton Berisha- foli për rastin konkret që ndërlidhet me takimin e përbashkët të anëtarëve të GP + 6 dhe ministrit, ku ai nuk ka qen i ftuar në atë takim prandaj nuk ka njohuri për rrjedhat e shpalljes së konkursit plotësues. Konsideron se nuk është mirë të përsëriten praktikatat e njëjta pasi kjo çështje është e një rënësie së veçantë por duhet të inicohen nga ana e komisionit.

Me këtë rast shfrytëzojë mundësin të shpreh shqetësimin tim lidhur me çështjen e regjistrimit të studentëve të komunitetit pakicë të cilët kanë aplikuar në afat të parë në Universitetet e Prishtinës mirëpo nuk është arritur rezultati i konsiderueshëm. Mos përfillja e vendeve të rezervuara parqet shkelje të të drejtave të komunitetit jo shumicë. Për arritjen e këtyre kritereve, kërkohet edukim me kualitet të lartë dhe ndërprerje e akademizimit të të rinjve.

Danush Ademi, Sasa Milosavjevic, lidhur me çështjen e ngritur shprehën shqetësimet e tyre se është shumë i vogël numëri i kandidatëve të regjistruar në raport me 328 vende të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteit jo shumicë. Për tejkalimin e kësaj situatë kërkohet të ndërmerren masat e nevojshme në afat sa më të afërt, në të kundërtën do t'i rekomandojmë MASHT-it dhe Rektoratit të ndërmar veprime për shpallje të konkursit plotësues, për kandidatët e interesuar të komunitetit jo shumicë.

Agim Kikaj - duke pasur në konsideratë situatën e krijuar ai propozoi që në afat sa më të afërt të ftohet ministri i MASHT-it që të raportojë në Komision, se a është siguruar qasje e barabartë për shkollim superior në nivelin universitar, a përcaktohen masa të veçanta lidhur me sigurimin e këtyre të drejtave, si dhe të sqarojë procedurën lidhur me regjistrimin në afat shtesë për kandidatët e komunitetit jo shumicë, në nivelin universitarë, për vitin shkollor 2015/16.

Kryesuesja, konstaton se komisioni për të Drejta, Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, nxjerr këtë:

Përfundim

Në përputhje me Rekomandimin e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të dt 21.09.2015, është në pritje të përgjigjes zyrtare nga ministri i MASHT-it, në përmbushjen e premtimit se do të mundësohet pranimi i kandidatëve të pa regjistruar nga komuniteti jo shumicë në afatin e parë për regjistrim në afatin e tretë, në Univerzitetin e Prishtinës 'Hasan Prishtina' në Prishtinë.

3. Të ndryshme.

Veton Berisha- kryesuesi i grpuit punues lidhur me monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil dha propozim, pas përfundimit të mbledhjes të qëndojnë anëtarët e GP, me qëllim të shtyhen përpara prioritetet e inicuar më herët dhe të respektohen afatet kohore për procedim në komision.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

E përgaditi:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Zhivkovic